

EKSHUMIMET NË SERBI, 2001

PËRMBLEDHJE

Për distribuim:
të Përgjithshëm
Beograd, qershor, 2002
ICMP.FSD.01.02.2.alb.doc

PËRMBLEDHJE E EKSHUMIMEVE TË MONITORUARA NGA ICMP GJATË VITIT 2001 NË SERBI

1. Raporti i mëposhtëm shkurtimisht përshkruan rezultatet e aktiviteteve monitoruese nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur në ish-Jugosllavi (ICMP), në një numër varrezash masive në Republikën Federative të Jugosllavisë (RFJ) të kryera nga autoritetet e Republikës së Serbisë në vitin 2001. Ky raport është shkruar që t'i komunikojë audiencës së gjerë e cila përfshin edhe asociacionet familjare, natyrën e këtyre vendeve, përbërjen e tyre, metodat e përdorura për ekshumimin e mbetjeve mortore dhe dëshmime tjera; si dhe konkludimet themelore. Ky nuk është dokument ligjor dhe si i tillë nuk reflekton pikëpamjet ose konkludimet e agjencive qeveritare apo instituteve të mjekësisë ligjore, të cilët janë të përfshirë në ekshumime dhe prej të cilëve pritet që të publikojnë deklarata.

1. Historiku i shkurtër

2. Në Prill të vitit 2001, informatat filluan të dalin nëpër media për një apo më shumë kamionë të përdorur për transportimin e një numri të madh kufomash të shqiptarve nga Kosova, viktimat këto që rezultuan nga konflikti i vitit 1999 dhe u varrosën fshehurazi në disa lokacione në Serbi; ku më pastaj autoritetet e Republikës së Serbisë donin të bëjnë ekshumime në po të njëjtat lokacione. ICMP-së iu dha leja të monitorojë dhe të raportojë për ekshumimet dhe ekzaminimet e mbetjeve mortore, edhe pse në atë kohë ICMP-ja nuk ishte formalisht e regjistruar në RFJ. Përafërsisht, janë rreth 3,600 raporte të personave të zhdukur në Kosovë, prej të cilëve 2,700 janë shqiptarë. Proporcioni i këtyre të fundit që janë transportuar në Serbi është momentalisht i panjohur, mirëpo supozohet se janë qindra sosh.
3. Një monitorues i ICMP-së ka qenë prezent gjatë periudhës qershor-shtator 2001, kur ekshumimet u ndërprejnë për të pritur ekshumimet e mëtejshme të vitit 2002. Pesë lokacione u procesuan. Është raportuar që afro 423 mbetje mortore janë zhvarrosur gjatë kësaj periudhe kohore. Sidoqoftë, është e domosdoshme që ky numër të kuptohet qartë. Shumica e këtyre varrezave janë sekondare; d.m.th mbetjet mortore nuk janë mbledhur dhe varrosur menjëherë. Më saktë, ka ekzistuar periudha kohore gjatë së cilës mbetjet mortore janë dekompozuar dhe kanë qenë nën ndikime të ndryshme. Poashtu, proceset e mbledhjes së kufomave, transporti i tyre, dhe përfundimisht varrimi, kanë bërë që ato mbetje mortore të zbërthehen, dëmtohen, përzihen, e madje edhe të jenë të pakompletuara. Kjo gjë është e zakonshme për viktimat e konflikteve që kanë ndodhur në ish-Jugosllavi nga viti 1992. Këto procese krijojnë një situatë të rëndë forenzike për ata që janë përgjegjës për ekshumimet dhe ekzaminimet e mbetjeve mortore për qëllime të identifikimit. Është më se e mundur që jo të gjithë individët nga këto varreza do të identifikohen. Për më shumë, jo të gjitha mbetjet mortore do të jenë komplete. Poashtu, vlen të theksohet që nacionaliteti nuk tregohet përmes indeve biologjike; edhe pse disa objekte siq janë rrobat dhe dokumentet, mund të krijojnë sypozime në këtë drejtim.

2. Konkludimet e Përgjithshme

4. Asnjë prej mbetjeve mortore nuk kanë qenë aq të paprekura sa që të lejohet identifikimi vizuel; edhe pse ka patur përjashtime të rralla, nuk ka ekzistuar as mundësia e vërejtjes së detajeve të ruajtuara të shenjave të gishtërinjve. Poashtu, kanë qenë prezente edhe disa shënime para-mortore mbi punën stomatologjike, të cilat mund të ndihmojnë gjatë identifikimit. Si deklaratë e përgjithshme, kufomat kanë qenë mjaft të dekompozuar; me fjale tjera kanë qenë pjesërisht apo totalisht vetëm skelete, përderisa organet interne nuk kanë qenë të përshtatshme për analiza histologjike. Pavarësisht nga kjo, një numër i madh

informatash është marrur, dhe atë në shumicën e rasteve për karakteristikat personale dhe shkakun e vdekjes.

5. Përderisa një pakicë e mbetjeve mortore kishin dokumente (p.sh. Letërnjoftim), nuk ka garancione që të njëjtat ishin të personit në fjalë. Si pasojë, identifikimet duhet të provohen përmes një kombinimi të burimeve duke përfshirë, rrobat dhe gjërat personale, veçoritë klasike anatomike (p.sh. procedurat e operacioneve), shenjat osteologjike të gjinisë dhe moshës në momentin e vdekjes, si dhe ADN-së. Është e detyrë e autoriteteve të cilat bëjnë identifikimin, që identiteti i indikuar me ADN të jetë konsistent me informatat tjera siq janë moshja, gjinia, dhe gjërat personale, si dhe nëse ka mospërputhje që ato të shpjegohen.
6. Momentalisht, ekziston një revolucion në mundësinë e shkencëtarëve të mjekësisë ligjore, për të bërë identifikimin e individit në bazë të ADN-së së mbetur në inde; dhe atë në eshtra dhe dhëmbë. Individët në lidhje gjaku, kanë detaje të përbashkëta të strukturës biokimike e cila lejon identifikimin e qartë të mbetjeve mortore. Këto procedura shkencore janë valide dhe të pranuar ndërkombëtarisht. ICMP ndihmon përpjekjet për grumbullimin e mostrave të gjakut nga të afërmit biologjik të personave të zhdukur në ish Jugosllavi, dhe në Kosovë.

3. Lokacionet

7. Këto lokacione janë të përshkruara sipas renditjes së procesimit. Nuk ka implikime në renditjen sipas të cilës janë krijuar ato.

3.1. Batajnica I

a) Lokacioni

8. Ky lokacion gjendet në bazën SAJ (Njësi Special Anti-terrorist) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) afër Batajnicës, pak kilometra në veriperendim të Beogradit.

b) Hetuesit

9. Hetimi është bërë nga Gjykata e Qarkut në Beograd, me ndihmën e një ekipi ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Beograd. Asistimi i mëtejshëm është siguruar nga stafi i Fakulteti i Mjekësisë pranë Univerzitetit të Beogradit, si dhe Qendrës Shkencore “Petnica”. Vetura e Policisë ka siguruar vendin dhe çasjen në lokacion për 24 orë.
10. Edhe pse jo çdo ditë, monitoruesit nga organizatat e ndryshme kanë qenë prezent gjatë ekshumimeve; si Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY), Qendra Juridike Humanitare (HLC), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSCE).

c) Data(t)

11. Puna në këtë varrezë ka filluar me 1 qershor, 2001. Mbetjet mortore dhe dëshmitë tjera janë futur në një vend të siguruar më 18 korrik, 2001.

d) Konkludimet

12. Mbetjet mortore janë varrosur në një varrezë masive e cila është e gjerë 3x3 metra, dhe 2 metra e thellë. Procesi i zhvarrimit është komplikuar nga një numër i faktorëve. Së pari, kufomat kanë qenë të përziera, me disa raste të dislokimit të pjesëve trupore. Pjesët

qendrore të kufomave të gjetura nuk kanë qenë krejtësisht të djegura *in situ*, duke pasur copëzime dhe shtypje pasuese. Regjioni i tokës së djegur është zgjeruar në 3x4 metra.

Ekshumimi

13. Arkeologët kanë qenë prezent për të hartuar zhvarrimet primare dhe për të larguar ngarkesën e tepërt sistematike, gjatë pregaditjes për ekipin e patologëve të mjekësisë ligjore. Tendat e mëdha janë ngritur mbi sipërfaqen e varrezës, si dhe vendi për autopsi ku janë bërë ekzaminimet e kufomave. Mbetjet mortore janë nxjerrë jashtë me anë të veglave të vogla të dorës. Krahas përzierjes, djegies, dhe copëtimit të mbetjeve mortore, rëndësi e madhe i është kushtuar izolimit të kufomave dhe pjesëve të kufomave, përfshirë edhe rrobat dhe gjërat personale. Inçizimet videografike dhe fotografike janë bërë gjatë tërë operacionit. Vlen të theksohet që monitoruesit nuk kanë pasur të drejtën e fotografimit (në pajtim me vendimin e Gjykatës në bazë të ligjit për Procedura Kriminale).

Ekzaminimi

14. Shumica e mbetjeve mortore kanë qenë mjaft të paprekura, sa që të justifikohet autopsia tradicionale me mundësi të ekzaminimit histologjik të organeve, përderisa të tjerat kanë qenë objekt i ekzaminimit të thjeshtë postmortor. Patologët i janë përmbajtur protokollit standard postmortor. Të gjitha rrobat janë larguar, pastruar, përshkruar dhe fotografuar. Një antropolog ka ekzaminuar eshtrat e selektuara, për të përcaktuar gjininë dhe moshën në momentin e vdekjes. Poashtu, janë bërë edhe vrojtimit stomatologjike. Disa nga mbetjet mortore i janë nënshtruar radiografisë në Beograd.
15. Në media është theksuar që së paku 36 individë janë zhvarrosur nga ky lokacion, saktësisht 13 meshkuj, 14 femra, dhe 9 fëmijë. Si shtesë, ka qenë edhe një fetus tetë muajsh. Edhe pse mostrat e eshtrave janë marrë për ADN, ky proces nuk është monitoruar nga ICMP-ja. Poashtu, janë zhvarrosur edhe disa dokumente personale.
16. Dëshmitë e mjekësisë ligjore janë marrë, përshkruar dhe fotografuar. Vërejtjet specifike kanë qenë përgjegjësi e patologëve të mjekësisë ligjore. Marrë parasysh numrin e mbetjeve mortore, është e çuditshme se ka pasur shumë pak dëshmi rreth mënyrës së vdekjes së këtyre individëve.

3.2. Petrovo Sello I dhe II

17. Këto lokacione janë shumë afër dhe si të tilla janë procesuar në të njëjtën kohë nga i njëjti ekip; e poashtu janë edhe të përshkruara së bashku.
 - a) **Lokacioni**
18. Këto varreza janë emëruar sipas fshatit të afërt i cili gjendet në një distancë prej 30 minuta vozitjeje nga Klladovo, në Serbinë lindore. Afër varrezave gjendet vendi i cili nga mediat është përshkruar si ish-kampi për trajnime të forcave speciale të Policisë. Të dy këto varreza të cilat janë afro 150 metra larg njëra tjetrës, gjenden në një regjion të izoluar me male. Nga këto dy lokacione, Petrovo Sello I është varrezë më e vogël.
 - b) **Hetuesit**
19. Hetimet janë bërë nga Gjykata e Qarkut në Negotin, me ndihmën e ekipit të ekspertëve nga Instituti i mjekësisë ligjore në Nish. Edhe pse jo çdo ditë, monitoruesit nga organizatat e ndryshme kanë qenë prezent gjatë ekshumimeve; si Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY), Qendra Juridike Humanitare (HLC), dhe Organizata për

Siguri dhe bashkëpunim Evropian (OSCE). Vetura e Policisë ka siguruar vendin dhe çasjen në lokacion për 24 orë.

c) Data(t)

20. Punimet në Petrovo Sello I kanë filluar para vizitës tonë të parë, të bërë më 25 qershor, 2001. Ekshumimet kanë përfunduar më 26 qershor. Po të njëjtën ditë më vonë, ekshumimet kanë filluar në Petrovo Sello II dhe kanë përfunduar më 28 qershor. Autopsitë e mbetjeve mortore nga Petrovo Sello I kanë qenë në përfundim e sipër më 25 qershor, dhe janë përfunduar më 27 qershor. Autopsitë e mbetjeve mortore nga Petrovo Sello II kanë filluar më 27 qershor dhe kanë përfunduar më 1 korrik, edhe pse punimet në rroba kanë zgjatur deri më 4 korrik.

d) Konkludimet

21. Struktura në teren përfshinte stacionin e personelit dhe tendën për autopsi, përfshirë këtu edhe tendën për ruajtje të përkohshme të kufomave. Poashtu është mirëmbajtur edhe një vend i hapur për zierjen, shpërlarjen dhe tharjen e rrobave.

Ekshumimi (Rivarrimi)

22. Disa makina të mëdha për lëvizjen e dheut janë sjellur në lokacion për të hequr dheun e tepërt, dhe më pastaj për ta rrafshuar atë. Ato poashtu u përdorën për hapjen dhe rrafshimin e dheut në varrezën e përkohshme. Kjo ka qenë tejet e nevojshme sepse ekipi nuk kishte mundësi të sigurojë një kamion me frigorifer.
23. Ekshumimi i kufomave në Petrovo Sello I dhe nivelin sipërfaqësor në Petrovo Sello II, nuk është monitoruar. Është deklaruar që në nivelin më të ulët të varrezës në Petrovo Sello I, ishin 13 kufoma të tërësishme dhe një pjesë e ndarë me tri kufoma në nivelin sipërfaqësor.
24. Në Petrovo Sello II, mbetjet mortore të ruajtura mirë kanë formuar një masë kompakte 3x3 metra, me një thellësi prej 1.5 metra. Me heqjen e dheut të tepërt, ekshumimi ishte mjaft i lehtë. Veglat e vogla për zhvarrim përbëheshin nga disa lopata, kazma, dhe një mistri. Gjatë tri ditëve të punës, 59 kufoma (shih më poshtë - të shënuara me numrat 1-8 dhe 8a-58) janë nxjerrur nga një gropë e vogël por e thellë, me dimensione 3x3 metra dhe një thellësi prej 3.5 metra.

Ekzaminimi

25. Ruajtja e mbetjeve mortore në të dy lokacionet ka qenë mjaft e mirë, me sa duket për shkak të thellësisë së varrezës e cila ka lejuar aplikimin e procedurave të zakonshme të autopsisë. Ky hap është bërë në teren. Në lokacion nuk ka patur mjete radiografike ose të detektimit të metalit. Të gjitha konkludimet e autopsive dhe përshkrimet e rrobave kanë qenë të regjistruara me dorë, ose të shkruara përmes diktimit. Antropologu nuk ka qenë prezent. Siq u cek, mbetjet mortore kanë pasur mbetje të mishit, kështu që ekspertiza osteologjike nuk është aplikuar. Para fillimit të autopsive, fotografi ka inçizuar gjendjen e mbetjeve mortore, duke e futur etiketën me numër në plan të parë. Ngjajshëm, regjistrimet fotografike dhe videografike janë bërë gjatë tërë procesit. Mostrat e indeve janë marrë për analizë histologjike; siq janë marrë edhe mostrat e eshtrave për analizën e ADN-së.
26. Në të dy lokacionet, një kohë e konsiderueshme është shpenzuar për pastrimin, përshkruarjen, dhe regjistrimin e rrobave të shumta. Restaurimet e veçanta stomatologjike, urat e dhëmbëve, dhe protezat janë përshkruar e fotografuar, ku këto të fundit janë ndarë si dëshmi. Patologët deklaruan se në bazë të indeve të buta dhe rrobave, të gjithë 16 individë nga Petrovo Sello kanë qenë meshkuj. Fëmijë nuk ka pasur. Një raport i fundit në media

jep indikacione që 61 kufoma janë zhvarrosur nga Petrovo Sello II. Një dokument personal është gjetur në nivelin sipërfaqësor të kufomave në Petrovo Sello I, dhe disa dokumente janë gjetur në Petrovo Sello II.

27. Dëshmitë e mjekësisë ligjore janë marrë, përshkruar, dhe fotografuar. Shumica e kufomave i ishin ekspozuar dëmtimeve të rënda *perimortem*, në klavikula dhe pjesët tjera të trupit. Konkludimet specifike kanë qenë përgjegjësi e patologëve të mjekësisë ligjore. Raporti mbi mediat, i publikuar nga Instituti për Mjekësi Ligjore në Nish, thekson që në 60 raste vdekja u shkaktua nga plagët me të shtëna, përderisa 9 të tjerë kanë vdekur nga trauma prej mjeteve jo të mprehta; kurse në 8 raste shkaktari i vdekjes është i panjohur.
28. Në fund të projektit, ekipi vendosi shenjat me numra mbi varreza, të cilët i përgjigjeshin numrave të qeseve me kufoma në varrezën e përkohshme.

3.3. Batajnica II

a) Lokacioni

29. Ky lokacion gjendet në bazën SAJ (Njësi Special Anti-terrorist) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) afër Batajnicës, pak kilometra në veriperendim të Beogradit. Kjo varrezë është vetëm 100 metra larg, në jug të Batajnicës I. I tërë regjioni është poligon për ushtrime me armë zjarri. Është pohuar që ekzistojnë më shumë varreza në regjionin e afërt i cili ka një dimenzion prej 70 metra në veri-jug dhe 50 metra në lindje-perendim.

b) Hetuesit

30. Hetimi është bërë nga Gjykata e Qarkut në Beograd, me ndihmën e një ekipi ekspertësh nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Beograd. Asistimi i mëtutjeshëm është siguruar nga stafi i Fakulteti i Mjekësisë pranë Univerzitetit të Beogradit.
31. Edhe pse jo çdo ditë, monitoruesit nga organizatat e ndryshme kanë qenë prezent gjatë ekshumimeve; organizatat si Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY), Qendra Juridike Humanitare (HLC), dhe Organizata për Siguri dhe bashkëpunim Evropian (OSCE). Prezent ishin edhe një përfaqësues i Komitetit të RFJ-së për mbledhjen e të dhënave mbi krimet kundër njerëzimit dhe ligjin ndërkombëtar, si dhe Instituti i Shkencave dhe Mjekësisë Ligjore nga Prishtina. Eksperti nga Prishtina ishte prezent vetëm njëherë. Sigurimi ishte bërë vetvetiu për shkak se vetë lokacioni gjendej në bazën e SAJ (Njësi Special Anti-terrorist). Vetëm personat që kishin leje nga gjykata ishin të lejuar përbrenda lokacionit.

c) Data(t)

32. Punimet në këtë varrezë filluan më 10 korrik, 2001, dhe përfunduan më 21 shtator. Monitoruesi i ICMP-së ka qenë prezent prej 10 korrikut deri më 10 gusht, dhe prej 17 deri më 21 shtator.

d) Konkludimet

33. Një punë kaq e madhe përfshin kërkesa të veqanta logjistike, përfshirë edhe pajisjet, transportin, strukturat përkrahëse dhe furnizimet rutinore. Pajisjet e rënda që janë përdorur në këtë lokacion kanë përfshirë pajisjet për heqjen e dheut (shatet e vogla dhe të mëdha) dhe kamionin me ujë për larjen e rrobave dhe higjienën personale. Një varg i strukturës së përkohshme u krijua, përfshirë tendën për mbulimin e varrezës, tendën për autopsi dhe dy tenda të përkohshme për ruajtjen e kufomave. Veglat e vogla të dorës (p.sh. mistritë) janë

përdorë për ekspozimin e kufomave. Ekipi ka qenë në këtë lokacion në vazhdimësi për dhjetë javë të tëra.

34. Operacioni i nxjerrjes së kufomave është komplikuar nga një numër faktorësh. Së pari, disa mbetje mortore kanë qenë të pakompletuara; së dyti, mbetjet mortore kanë qenë të shformuara keq dhe të përziera, duke e bërë kështu shumë të vështirë gjurmimin e këmbëve dhe të duarve; së treti, një numër i madh gomave të automjeteve me rrjetën e tyre përbërëse, ishte djegur duke u munduar së koti të shkatërrohen kufomat; së katërti, kjo ishte një varrezë e madhe me më shumë se 250 mbetje mortore. Kjo varrezë masive e monitoruar nga stafi i ICMP-së, ka qenë ndër më të vështirat që është ekshumuar ndonjëherë. Gjykata nuk ka lejuar monitoruesit ndërkombëtar të fotografojnë përmbajtjen e varrezave apo aktivitetet e ekipeve forenzike.

Ekshumimi

35. Asnjë arkeolog nuk ka qenë i involvuar në hartografimin ose ekshumimin e kësaj varreze. Një ekskavator është përdorur për heqjen e dheut sipërfaqësor, gjë e cila nxorri në shesh rrobat dhe fragmentet e eshtrave me origjinë të pasigurt. Distribuimi i tyre është përdorur për përcaktimin e skajeve të gropës së thellë lineare të mbushur me dhe e kufoma. Sipërfaqja perëndimore e dëshmimeve nuk ishte e qartë deri në fund të operacionit. Ekshumimi i pjesës perëndimore të varrezës masive nuk është monitoruar. Dimenzionet përfundimtare të regjionit të gërmuar ishin përafërsisht 15x10 metra, me një thellësi prej 2,80 metra.
36. Kujdes i veçantë është treguar nga patologët e mjekësisë ligjore për të izoluar mbetjet mortore individuale, çdo herë që ka ekzistuar mundësia për t'a bërë atë para ngritjes së kufomës. Sidoqoftë, problem i vazhdueshëm ka qenë nxjerrja e mbetjeve mortore të cilat qartë kanë qenë complete. Pjesët e trupit që nuk kanë mundur të interpretohen si një individ, janë grumbulluar si elemente të izoluar përbrenda këtij sektori; kanë qenë 16 njësi një-metërshe (përafërsisht të definuara dhe të ruajtura gjatë vazhdimit të ekshumimit). Përmbajtja e secilit sektor është ekzaminuar më vonë, si pjesë e procesit për llogaritjen e numrit minimal të individëve. Nuk ka pasur ndonjë renditje apo ndonjë orientim të kufomave; ato thjeshtë ishin shkarkuar si një masë e përzier. Para nxjerrjes, secila mbetje mortore me etiketë është fotografuar nga largësia dhe nga afërsia (inçizime fotografike dhe videografike).
37. Përafërsisht gjysma e varrezës është gërmuar prej anës lindore, duke iu afruar masës së kufomave anash dhe sipër, duke bërë kështu një progres të ngadalshëm kah ana perëndimore. Kjo shmangje nga procedurat e zakonshme të punës prej lartë e pastaj teposhtë, ishte e nevojshme për shkak të natyrës së përzierjes të mbetjeve mortore në margjinën veriore.
38. Vështirësitë u rënduan me rrobat të cilat ishin pjesërisht të shqyera nga mbetjet mortore. Kjo e fundit e kombinuar me gomave të djegura, e bëri punën me mistri shumë frustruese. Më thellë brenda varrezës u ngrit numri i mbetjeve complete mortore, mirëpo ato ishin nën ndikimin negativ nga regjionet ku ishin koncentruar djegjet, për shkak se me këtë ishin djegur totalisht eshtrat e gjymtyrëve dhe kishin mbetur vetëm mbetjet. Shpeshherë, kafkat ishin të thyera në kënde të çuditshme, pra ato nuk ishin aq të përdorshme sa mund të jetë menduar gjatë izolimit të kufomave. Më të përdorshmet ishin nyjet dhe boshti kurrizor; ku prej këtyre pjesëve gjurmoheshin pjesët tjera të trupit. Nganjëherë, pjesa e trupit ose gjërat personale do të merreshin për bazë dhe do të regjistroheshin, mirëpo, ka ndodhur të kalojnë prej një deri në dy javë para se të nxjerrej pjesa e mbetur e trupit.
39. Kur mbetja mortore ishte e izoluar mirë për të bërë nxjerrjen, asaj i ngjitej numri pasues dhe fotografi thirrej për të regjistruar lokacionin e kufomës, dukjen, si dhe veçoritë e

dukshme si stolitë e çmuara. Fotografi poashtu ka bërë një numër inçizimesh videografike me zë gjatë tërë procesit të ekshumimit. Çdo mbetje mortore është vendosur në një qese të re, dhe pastaj është dërguar në tendën e ruajtjes për ekzaminime të mëtutjeshme.

Ekzaminimi

40. Batajnica II ka qenë varreza e dytë që është procesuar gjatë kësaj sezone nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Beograd. Si pasojë, procedurat e njëjta janë përdorur si më lartë në rastin e Batajnicës I. Një numër i vogël i mbetjeve mortore kanë qenë aq të paprekura sa që të mund të behët autopsia tradicionale. Mbetjet mortore me skelet të theksuar u pastruan, dhe eshtrat u vendosën sipas renditjes anatomike për të bërë vlerësimin dhe për të bërë fotografimin.
41. Të gjitha rrobat janë larguar, pastruar, përshkruar dhe fotografuar. Një antropolog ka ekzaminuar eshtrat e selektuara për të përcaktuar gjininë dhe moshën në momentin e vdekjes. Poashtu, janë bërë edhe vrojtimet stomatologjike. Disa nga mbetjet mortore i janë nënshtruar radiografisë në Beograd.
42. Është raportuar që së paku 269 individë janë zhvarrosur nga ky lokacion. Numrat janë të përafërt për shkak të arsyeve të përmendura në fillim të këtij dokumenti. Ishin 253 mbetje mortore në të cilat u vendosën etiketa gjatë ekshumimit; dhe ky numër është rritur pas ekzaminimit antropologjik të eshtrave të izoluara prej sektorëve anësorë për 16 individë të tjerë. Të dhënat mbi kufomat dhe dëshmitë janë mirëmbajtur nga ekipi në tabelën e krijuar në kompjuter. Vërehej se të gjithë individët nga kjo varrezë ishin meshkuj “civilë”, të cilët ishin të moshës adoleshente deri në atë të mesme. Patologët e Mjekësisë Ligjore lëshuan diagnozën përfundimtare. Mostrat e indeve të eshtrave u morrën nga të gjithë 269 individë të analizën e ADN-së.
43. Kishte shumë rroba (disa të djegura) dhe gjëra personale. Më shumë se dhjetë letërnjoftime u gjetën.
44. Ndryshe prej Batajnicës I, ky lokacion kishte dëshmi të konsiderueshme për patologë, ku gjatë ekzaminimit të indeve njerëzore ato mund të indikonin se sa prej këtyre individëve kishin vdekur. Shumica e këtyre dëshmime ishte e natyrës balistike.
45. Në fund të procesit, mbetjet mortore u vendosën në qeset me numra rendorë dhe u larguan nga tendat për ruajtje. Në fund të procesit, mbetjet mortore u transferuan në një vend të sigurtë.

3.4. Gryka e Derventës, Liqeni Peruçac

a) Lokacioni

46. Ekshumimi u bë në veri të lumit Derventa afër kryqëzimit me liqenin Peruçac, 13 km prej Bajina Bashtës, në Serbinë perëndimore. Fshati Rastishte gjendet 2km më lartë përgjatë rrugës së grykës.

b) Hetuesit

47. Hetimi është bërë nga Gjykata e Qarkut në Uzhice, me ndihmën e një ekipi ekspertësh të udhëhequr nga patologu ushtarak prej Akademisë Mjekësore-Ushtarake në Beograd, si dhe Instituti për Patologji dhe Mjekësi Ligjore. Asistimi i mëtutjeshëm është siguruar nga stafi i Fakulteti i Mjekësisë pranë Univerzitetit të Beogradit.

48. Edhe pse jo çdo ditë, monitoruesit nga organizatat e ndryshme kanë qenë prezent gjatë ekshumimeve; si Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish Jugosllavi (ICTY), Qendra Juridike Humanitare (HLC), dhe Organizata për Siguri dhe bashkëpunim Evropian (OSCE).

c) Data(t)

49. Puna në varrezë filloi më 6 shtator, 2001. Regjistrimet videografike vazhduan deri më 8 shtator, 2001. Është deklaruar që ekipi ka kaluar tri ditë të plota në lokacionin e varrezës. Monitoruesi i ICMP-së ka qenë prezent në lokacionin e ekshumimit deri më 10 shtator. Autopsitë janë bërë në një vend të përkohshëm, duke filluar më 9 shtator, përdërisa monitorimi pati filluar në pasditën e 10 shtatorit, dhe përfundoi më 14 shtator.

d) Konkludimet

50. Kjo veprimtari përfshiu kërkesa të veqanta logjistike si pajisjet, transportin, strukturat përkrahëse dhe furnizimet rutinore. Sidoqoftë, në krahasim me shumicën e varrezave tjera të procesuara në Serbi gjatë kësaj sezone, sfidat kanë qenë modeste. Operacioni ka qenë mjaft mirë i pregaditur dhe kishte staf të mjaftueshëm për ekshumime, larje rrobash, dhe procesimin e mbetjeve mortore. Detektori i metalit është përdorur për zbulimin e varrezës, pasi që kjo varrezë përmbante pjesët e kamionit frigofer; kontejner ky në të cilin janë mbajtur kufomat; ku sipas pohimeve janë vendosur në liqenin Peruçac më 1999. Kjo ishte varrezë sekondare që përmbante mbetje mortore të afektuara nga imersimi i mëparshëm në liqenin Peruçac, nxjerrja e po të njëjtave, dhe përfundimisht varrimi. Poashtu, lokacioni periodikisht ishte nën ndikimin e ujit të liqenit Peruçac. Këta faktorë së bashku me tharrjen e pusit dhe zhavorrin e vrazhdë ku mbetjet mortore janë vendosur, shpjegojnë përse të gjitha mbetjet mortore kanë qenë të skeletuara.

Ekshumimi

51. Edhe pse ky ekshumim nuk është monitoruar, monitoruesit, përfshirë këtu edhe ICMP-në, janë lejuar të shikojnë regjistrimet videografike të ekshumimit. Varreza është gërmuar në zhavorrin e grykës pranë lumit Derventa, afër bregut të pjerrtë të përbërë prej gurrëve të vrazhdë dhe dheut të paktë. Ekipi rigërmoi një regjion prej 4x6 metra. Ata zbuluan mbetje mortore dhe komponente të metalit në frigoferin e kamionit në një thellësi prej 1.5 metra. Mbetjet mortore dhe dëshmitë tjera janë nxjerrur prej aty me punë dore. Të dy, pjesët e kufomave komplete dhe jo-komplete së bashku me rroba, janë zbuluar gjatë izolimit të një numri të eshtrave.

Ekzaminimi

52. Autopsitë janë bërë në një tunel të madh dhe ndërtesat e afërta të fabrikës së braktisur për prodhimin e cementit në Mt. Tara, për shkak se aty bëhej sigurimi 24 orësh. Së pari, monitoruesit ndërkombëtar ishin prezent në lokacionin ku bëheshin autopsitë në pasditën e datës 10 shtator, moment ky në të cilin ekzaminimi postmortor i kufomës D.5 u përfundua (ishin gjithsej 26 kufoma). Si shtesë, ishin 52 kufoma parciale me etiketa edhe pse disa prej këtyre të fundit ishin eshtra të izoluara. Para ekzaminimit, përmbajtja e secilës qese ishte regjistruar me videokasetë dhe fotografi. Pjesët e pakompletuara të mbetjeve mortore janë mbajtur së bashku me rrobat. Këto të fundit janë pastruar me dorë, përshkruar, fotografuar, dhe vendosur në kontejnerë me etiketa. Që të dy, eshtrat dhe rrobat ishin dëshmi të djegjes në pjesët e izoluara të tokës. Nuk kishte dëshmi se kjo djegje ndodhi në vendin e varrimit.

53. Eshtrat ishin të vendosura sipas renditjes anatomike dhe u ekzaminuan nga dy patologë të mjekësisë ligjore, njëri prej të cilëve i diktonte tjetrit konkludimet. Një vërejtje është bërë

rreth shënimeve klasike osteologjike të gjinisë dhe moshës në momentin e vdekjes, posaçërisht nga antropologu i cili ishte përgjegjës për analizën demografike. Në disa raste, ishte i mundur riasociimi i pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit. Është konkluduar që kishte së paku 48 individë, prej të cilëve 38 ishin meshkujë, dhe një ishte femër. Moshë ishte prej mesatarisht adoleshente, deri në më të vjetër. Mostrat e eshtrave prej të gjithë 48 individëve, si dhe pjesët e sipërme të paasociuara janë marrë për analizën e ADN-së.

54. Shumë pak gjëra personale janë zhvarrosur. Dhëmbët dhe protezat janë regjistruar dhe ruajtur. Së paku dy dokumente personale janë vërejtur. Një skelet i femrës, kishte një pllakëz të dallueshme kirurgjike për rregullimin e frakturës në pjesën e poshtme të këmbës.
55. Në shumë raste, kishte dëshmi balistike si dhe plagë klasike në kokë të shaktuara me armë zjarri.
56. Vendi për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve mortore ishte i vendosur afër Bajina Bashtës, mirëpo u deklarua se me siguri ato do të dërgohen në Beograd.

e) Konkludimet Përmblyëse

57. Në rrethana normale, ekspozimi i kujdesshëm i mbetjeve mortore me rroba dhe masave trupore të dekompozuar, nuk është shkathtësi të cilën e posedon patologu i mjekësisë ligjore. Në këto lokacione, patologët kanë pranuar detyrën e gjurmimit dhe zhvarrosjes së kufomave, më së shumti për shkak të njohurive esenciale që posedojnë mbi anatominë njerëzore dhe mundësisë për të bërë zbulimin e pjesëve trupore. Sidoqoftë, përfshirja e arkeologëve dhe shkathtësive të tyre për të bërë gjurmimin me kujdes, si dhe përdorimi pedant i mistrive; kanë qenë të domosdoshme për ekshumimet në të ardhmën. Kjo do të sigurojë që këto mbetje mortore fatkeqsisht jo complete, të ekspozohen dhe të mbledhen; si dhe hartografimin e dëshmimeve dhe kufomave sipas standardeve adekuate.
58. Krahas sfidave të prezentuara në varrezat e ndryshme, ekipet Serbe kanë kryer detyrat e tyre të zhvarrosjes dhe ruajtjes së mbetjeve mortore në pajtim me standardet e arsyeshme ndërkombëtare, të pranueshme. Ekipet iu përshtatën mirë kërkesave dhe detyrës së monitoruesve ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore, duke prezantuar dhe shpjeguar në tërësi metodat e përdorura.